



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN  
PUBLIC UNIVERSITY "KADRI ZEKA" GJILAN  
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390

---

## Fjala mirëseardhëse e rektorit Bajram Kosumi për studentët e rinj në Universitetin Publik "Kadri Zeqa" Gjiilan

### 1. Përshëndetjet

Të dashur studentë!

Sigurisht është hera e parë që dikush po ju përshëndetë me emërtimin "student".

Urime ky emër kaq i bukur që dy mijë e pesëqind vjet!

Edhe një herë pra,

Të dashur studentë mirë se erdhët!

### 3. Sot për secilin nga ju fillon një histori e re.

Dita e sotme është një kufi. Gjithmonë do ta kujtoni këtë ditë. Do të thoni: atë ditë kur fillova studimet!

Po, ky është 1 Tetori juaj.

Po filloni një jetë të re.

Nga sot e tutje do ta trajtoni shumë më seriozisht çdo ide, çdo hap e çdo veprim tuajin. Një ide, një hap apo një veprim i mençur do të ju shpjerë drejt majave, drejt suksesit dhe drejt përparimit. Një ide, një hap apo një veprim i gabuar mund t'u shmang nga ky sukses.

### 4. Të dashur studentë

Gjithçka varet nga puna, përkushtimi dhe vullneti juaj për sukses në jetë. Ju shpresoni, por edhe familjet tuaja shpresojnë te ju. Edhe ne shpresojmë te ju.

Ndoshta e keni dëgjuar një këngë të Alban Skenderit në të cilën thuhet se *asgjë nuk të jepet falë, gjithçka e ka një çmim*. Suksesi ka një çmim të madh, por ka vetëm një rrugë për ta paguar atë çmim: puna dhe djersa. Të gjithë të tjerat, absolutisht të gjitha të tjerat, janë vetëm suksese të rastit, rastësi dhe jetëshkurtra.

Vetëm puna dhe djersa ua sigurojnë suksesin dhe përparimin. Jam i lumtur që e kam kuptuar këtë dhe e përsëris shpesh se këtë botë e fiton vetëm ai që punon dhe jeton nga djersa e tij.

Të tjerët janë kalimtarë.

### **5. Do të keni shumë ftesa për të ikur nga puna dhe djersa.**

Në çdo qoshe do të ju thotë një zë "eja, lere mësimin, lere punën, një jetë kemi, eja kënaqu!" Kjo ju ndodhë të gjithëve. Edhe mua më ndodhë. Vetëm njerëzit e vërtetë, të mençur e të vendosur për ta fituar këtë jetë nuk do ta dëgjojnë këtë thirrje.

### **6. Dua ta përmend këtu alpinisten e njohur, bashkëqytetare juaja, Uta Ibrahim.**

Në një ligjëratë për studentë te gazetarisë në UP Prishtinë, ajo tregoi se shkonte të flinte në orën njëzetën, sepse duhej të zgjohej herët për të vrapuar. Jam e privuar nga jeta që bëjnë shumica e rinisë, tha ajo, sepse më duhet të fle në kohën kur të gjithë shokët e shoqet e mia dalin në mbrëmje. Edhe unë do të doja të dilja, por më duhet të zgjohem herët, prandaj fle herët. Kjo është sakrificë, tha ajo, por ja vlen, sepse është lumturia më e madhe të mbërrish Mont Everest.

Të dashur studentë,

Edhe ju duhet të sakrifikoni nga koha dhe kënaqësitë e përditshme që të arrini në Mont Everest tuaj.

### **7. Por, të gjithë nuk do të arrini.**

Dikush do të ndalet në gjysmë të rrugës. Por, edhe ai kur ta kujtojë këtë ditë, 1 tetorin 2018, do të thotë: e pata një rast të mirë dhe nuk e shfrytëzoza! Më iku Mont Everesti im!

### **8. Ndonjë koleg imi do të më thotë pas këtij takimi:**

pse ua përmende edhe mundësinë e dështimit? Kjo është dita ku duhet vetëm inkurajimi! Jo, do t'i them unë, kjo është dita kur duhet të ju inkurajojmë, por edhe t'ua tërheqim vëmendjen te përditshmëria që mund të ju trazojë dhe të ju largojë nga rruga e suksesit. Duhet të jeni çdo ditë të vëmendshëm, çdo ditë të për qëndruar te sukcesi, për ta arritur atë!

### **9. Tash do të ju them pak fjalë për universitetin dhe çka do të ju ndihmojmë ne në rrugën tuaj të suksesit.**

UKZ është universitet i ri, por me shpresa të mëdha.

Kemi 4 fakultete, studimet bachelor dhe master, 8 mijë studentë, një staf akademik prej rreth 40 profesorëve dhe asistentëve dhe një administratë prej rreth 20 zyrtarëve. Buxheti ynë vjetor është pak mbi 2 milion. Objekti ku zhvillojmë procesin mësimor është ky ku jemi. Pak a shumë ky është letërnjoftimi ynë.

Besojmë shumë, dhe shpresojmë, që ky letërnjoftim do të ndërrohet brenda 5 vjetëve. Do të kemi më shumë fakultete, do të krijojmë edhe studimet e doktoratës, do ta ndërtojmë kampusin e ri, buxheti ynë do të rritet...

Në këtë përparim tonin do të na ndihmoni edhe ju.

Deri atëherë ne do të ju ndihmojmë juve që të ecni përpara.

### **10. Ne do të kujdesemi**

që ligjëratat dhe ushtrimet të jenë të rregullta, që profesorët të ligjërojnë temat e syllabusit dhe asistentët të ju ushtrojnë për të njëjtat, që të pyeteni në provime dhe të vlerësoheni drejt për dijet e juaja, që të përgatiteni për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve apo për tregun e punës...

Përveç këtyre, do të kujdesemi që të merrni pjesë edhe në jetën akademike të universitetit dhe të jeni anëtarë të fuqishëm të familjes së madhe të universitetit tonë.

### **11. Ne fund, ju keni zgjedhur Universitetin " Kadri Zeka".**

Dikush nga dëshira dhe qëllimi i qartë në jetë, dikush nga se nuk ka pasur kushte të shkojë diku tjetër, dikush pse s'ka arritur të regjistrohet diku tjetër etj.

Ju keni provuar, por në fund këtu jeni.

Për asnjë rast mos mendoni se nuk keni zgjedhur universitetin e duhur! Ju garantoj se ju keni bërë zgjedhjen e duhur, më të mirën. Nuk e them këtë për dikë që ka provuar të regjistrohet në mjekësi e tash ka përfunduar në juridik. Ajo është çështje tjetër. Por e them për faktin se keni zgjedhur UKZ, e jo një universitet tjetër. Keni zgjedhur drejt dhe mirë. Do të bindeni gjatë tri dhe katër vjetëve të ardhshme.

Sot ne po ua ofrojmë një rrugë të vështirë, por e cila nesër ua garanton suksesin.

Prandaj, urime dhe suksese!

**1 tetor 2018**